

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarës Luljete Shabani, me praktikanten e kësaj Gjykate, Albana Islami, në lëndën penale kundër të akuzuarve A. M nga Gj për shkak të veprës penale, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-së, dhe V. Xh nga B, për shkak të veprës penale, Lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 390 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas propozimit të aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II nr. 1320/2014, të datës 04.08.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 11.05.2017, në prezence të palëve mori dhe shpalli, ndërsa më datë 16.05.2017 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

**I.** I akuzuari **A. M**, nga babai J, dhe nëna M, e lindur J, i lindur me datë, në Gj ku edhe jeton, i pa martuar, i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**II.** E akuzuara **V. Xh**, nga babai R, dhe nëna H, e lindur R, e lindur me datë, në B, jeton në Gj, e pa martuar, e pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

### JANË F A J T O R Ë

**I.** Sepse, i akuzuari i parë, **A.M**, më datë ..., rreth orës 02:30 në Gjn, në rrugën “...” (afër stacionit të autobusëve), për shkak të xhelozisë, i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të cilat kanë rezultuar me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të të dëmtuarit I. B nga fshati P. të, në atë mënyrë që të njëjtin e ka goditur me grushte në fytyrë për shkak se ky ishte shoqëruar me të dashurën e të pandehurit–tani të pandehurën e dytë V. Xh, me ç’rast të njëjtit i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore në fytyrë, në formë të plagëve shqyese e ndrydhëse në regjionin e buzëve,

- me çka ka kryer vepër penale, **Lëndimi i lehtë trupor**, nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-së.

**II.** Sepse, e akuzuara e dytë, **V. Xh**, më datë ..., në ora 14:30, në Gjilan, në Stacionin e Policisë, ka bërë lajmërim të rremë të personi zyrtar i ngarkuar me detyrën për të hetuar apo ndjekur, se personi i caktuar ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, duke e ditur se personi i tillë nuk është kryesi, në atë mënyrë që te ...i policisë në Stacionin e Policisë në Gjilan ka paraqitur personin e ashtuquajtur Valon Rexhepi nga Presheva si kryes të veprës penale nga paragrafi I i kësaj aktakuze, edhe pse e dinte se kryes i kësaj vepre penale nuk është i paraqituri por i dashuri i saj, tani i pandehuri i parë Ardian Maliqi nga Gjilani,

- me çka ka kryer vepër penale, **Lajmërimi apo kallëzimi i rremë**, nga neni 390 paragrafi 1 të KPRK-së, andaj Gjykata, bazuar në dispozitat e 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-ës, të akuzuarit:

## **I G J Y K O N**

**I. Të akuzuarin A. M - me Dënim me Gjobë në shumën prej 200 (dyqind) €**, të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguajë do ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën, Gjykata do të ia zëvendësojë me dënim burgu ashtu që do të i llogaritet shuma prej 20 € për një ditë burgimi.

I mundësohet të akuzuarit që dënimin e përmedur me gjobë ta paguajë me **4 (katër) këste**

**II. Të akuzuarën V. Xh – me Dënim me Kusht, Dënim Burgu në kohëzgjatje prej 3(tre) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara në afat prej **1 (një) viti** nuk kryen vepër tjetër penale.

**Obligohen** të akuzuarit që të paguajë paushallin gjyqësorë secili veq e veq, në shumën prej **20 (njëzetë) euro**, si dhe shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilani me datën 04.08.2014 ka paraqitur aktakuzën PP.II nr.1320/2014 ndaj të akuzuarve A. M për shkak të veprës penale, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-së, dhe V. Xh, për shkak të veprës penale, Lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 390 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe të denohen sipas ligjit.

Prokurorja e shtetit Rozelida Hasani, gjatë shqyrtimit gjyqësor të akuzuarit e pranuan fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen dhe me këtë u vërtuat në tërësi gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës, andaj, dhe kërkoi që gjykata të akuzuarit t'i shpallë fajtorë dhe t'ua shqiptojë sanksionin e paraparë ligjorë, si dhe para se të përcaktohet për lartësinë dhe llojin e dënimit, ti marrë parasyshtë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që iu vihen në barrë të akuzuarve.

I akuzuari A. M në fjalën përfundimtare deklaroi se është penduar për atë që ka ndodhur dhe i premtoi gjykatës se nuk do ta përsërisë këtë vepër e as vepra të tjera penale, si dhe kërkoi nga gjykata që t'ia shqiptojë një dënim sa më të butë që të jetë e mundur.

E akuzuara V. Xh në fjalën përfundimtare deklaroi se është penduar për atë që ka ndodhur dhe i premtoi gjykatës se nuk do ta përsërisë këtë vepër e as vepra të tjera penale, si dhe kërkoi nga gjykata që t'ia shqiptojë një dënim sa më të butë që të jetë e mundur.

Nisur nga një gjendje e këtyllë e konstatuar faktike, dhe nga pranimi i fajësisë, me veprimet e të akuzuarit A. M. përmbushen elementet e veprës penale, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-së, dhe me veprimet e të akuzuarës V. Xh. përmbushen elementet e veprës penale Lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 390 paragrafi 1 të KPRK-së, me çka Gjykata të njëjtit i ka shpallur fajtorë dhe i ka dënuar me dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se

*edhe me dënimet e tilla do të arrihet efekti i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës, dhe se këto dënime janë në përpjestim me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale dhe përgjegjësisë penale të kryerësve.*

*Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara, konform nenit 73 të KPRK\_ës dhe si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit pati parasysh sjelljen e mirë të tyre në Gjykatë, pendimin e tyre, shprehjen e keqardhjes së tyre, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale, si dhe peshën e veprës penale.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është i bazuar në nenin 453, të KPPK-së. Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Pnr. 831/14 më datë 16.05.2017**

***Praktikantja***  
***Albana Islami***

***Gjyqtarja e vetme gjykuese***  
***Luljete Shabani***

***KËSHILLA JURIDIKE:*** *Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj Gjykate.*